



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

28.07.2023

01-110/05-992

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17, 24 dhe neni 40, shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 19 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Rregullorja komunale Nr. 01-013/1706, e datës 23.12.2016, nenin 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 27.07.2023 merr këtë:

V E N D I M

për krijimin e kodeve të rinj për projektet me participim

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për krijimin e kodeve të rinj për projektet me participim me qytetar sipas kritereve të përcaktuara për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve.

Neni 2

Të lejohet krijimi i kodit të ri për subvencionimin e projekteve të parapara nga DBPZHR nga kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfereve.

Nr.	Emri i Projektit	Shuma totale të përfitura për operatorët në €	% e participimit të përfituesve	Shuma e participimit të përfituesve €	Shuma e participimit Komuna €
1	Mbjellëse dy rendëshe e patatës	9800.00	20%	1960.00	7840.00
2	Piatore	21400.00	20%	4280.00	17120.00
3	Freza 1.8m	26400.00	20%	5280.00	21120.00
4	Rotokosa	19600.00	20%	3920.00	15680.00
5	Shokluse misri	17000.00	20%	3400.00	13600.00
6	Makin për mbjelljen e misrit	19000.00	20%	3800.00	15200.00

Neni 3

Pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi Komunal mund të krijohen kode të rinj për projektet me participim.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Procedurat e Hartimi dhe Publikimi të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi